



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.09.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018 PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BE NË SEKTORIN EKONOMIK”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Edmond Leka.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte e pranishme znj. Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Kjo marrëveshje është propozuar nga pala gjermane, nisur nga dëshira për t’i forcuar e thelluar marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit teknik, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë në protokollin e bisedimeve qeveritare të datës 22.10.2018.

Objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti është forcimi i kompetencave për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, me fokus në disa kapituj të caktuar të legjislacionit të BE-së, që i përkasin sektorit ekonomik. Mbështetja dhe zbatimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për anëtarësim.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000,00 (dy milionë) eurosh.

Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së (rreth 65 000 euro) nëpërmjet institucionit përfitues, në përputhje me nenin 3, të marrëveshjes, si dhe me vendimin nr.509, datë 12.08.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së, që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë”.

Në marrëveshje përcaktohet se detajet e projektit si dhe detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve. Angazhimet e marra në kuadër të këtij projekti dhe, referuar shumës prej 2.000.000 eurosh, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit.

Në marrëveshje parashikohen gjithashtu rregullat për hyrjen në fuqi, ndryshimin, shfuqizimin dhe interpretimin marrëveshjes.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

EDMOND LEKA

ULSI MANJA